

Tabelat


- Jepet një vektor $V[N]$ me numra të plotë. Të ndërtohet një program që të zgjidhë këto detyra:
 - të gjejë mesataren MA të elementëve të vektorit;
 - të kontrollojë nëse ekziston në vektor një numër që të jetë i barabartë me mesataren e tij; nëse po, të jepet pozicioni.
- Jepet vektori $TEMP[365]$ ku janë vendosur temperaturat e matura në çdo ditë të vitit. Të ndërtohet një program që të afishojë se sa temperatura janë mbi $30^{\circ}C$ dhe sa janë nën $0^{\circ}C$.
- Jepet një vektor $V[M]$ me numra te plote. Të ndërtohet një program që gjen shumën e elementëve pozitivë dhe shumën e elementëve negativë të vektorit V dhe sa numra pozitivë dhe sa numra negativë ndodhen në një vektor të dhënë $V[N]$. Sa 0 ka vektori?
- Të ndërtohet një program C për të gjetur elementin minimal të një vektori dhe pozicionin e tij (duke supozuar se ai shfaqet vetëm një herë).
- Jepet vektori $V[N]$. Të ndërtohet një program që krijon një vektor të ri $A[N] = 3 * V[N]$.
- Në vektorin $NOTAT[N]$ jepen notat e studentëve të një grupi në lëndën e informatikës. Të ndërtohet një program C që gjen se cila është nota më e lartë që ka marrë ky grup dhe sa të tilla janë.
- Të ndërtohet një program C për të gjetur elementin maksimal të një vektori dhe:
 - pozicionin ku ai shfaqet për herë të parë në vektor;
 - pozicionin ku ai shfaqet për herë të fundit në vektor.
- Jepet një vektor $A[N]$. Të ndërtohet një program në C i cili të afishojë të gjithë ata elementë të vektorit që plotësojnë kushtin $A[i] = i$. Në rast se nuk ka elementë të tillë të afishohet mesazhi "Këta elementë nuk ekzistojnë".
- Të ndërtohet një program për të gjetur dy vlerat më të mëdha (më të vogla) të një vektori, të ndryshme nga njëra-tjetra.
- Të gjendet pozicioni i një numri X , në qoftë se ai ndodhet në një vektor $V[N]$.
- Jepet një vektor $V[N]$. Të ndërtohet një program në C që:
 - të numërojë sa herë gjendet një numër i dhënë A në vektor;
 - të numërojë sa herë figuron në vektor elementi i tretë i tij.
- Të rivendosen elementët e vektorit $V[N]$ në renditje inverse nga ajo e dhënë.
Zgjidhje. Në qoftë se elementët e tabelës janë

1	5	3	4	9
---	---	---	---	---

kërkohet që tabela të shndërrohet:


9	4	3	5	1
---	---	---	---	---

Kështu, elementi i parë ndërron vend me elementin e fundit, i dyti me të parafundit e kështu me radhë.




- Të ndërtohet një program C që çon elementin e k -të të një vektori V me N elementë, numra realë, në pozicionin e parë, elementin e $(k + 1)$ -të në pozicionin e dytë etj. Elementi i parë çohet në pozicionin e $(n - k + 1)$ -të e me radhë.

20. Jepet vektori $V[N]$. Tre elementët e fundit të tij të kalojnë në fillim, të tjerët të spostohen djathtas. Të afishohet vektori i modifikuar.
21. Jepet vektori $NOTA[N]$ ku janë regjistruar notat e studentëve të vitit të parë në lëndën e informatikës. Të formohet një vektor i ri $NOTA1$ që përmban ato nota që nuk janë mbetëse.
22. Jepet vektori $V[N]$. Të gjenden sa elementë të tij janë më të mëdhenj se një numër i dhënë X , duke afishuar edhe vlerën e tyre numerike e pozicionin që kanë në vektor.
23. Jepen vektorët $V[m]$ dhe $X[n]$. Të formohet vektori $Y[m+n]$ nga bashkimi i dy vektorëve të dhënë, siç tregohet në skemë:



24. Jepen vektorët V dhe X me N elementë secili. Të ndërtohet një program C për të formuar vektorin $Y[2N]$ me kapje të alternuar të elementëve nga vektorët V dhe X , pra



25. Në vektorin $TEMP[365]$ janë regjistruar temperaturat mesatare të matura për Tiranën në çdo ditë të vitit. Të zëvendësohet me 0 çdo vlerë temperature negative e regjistruar. Të afishohet vektori pas këtyre ndryshimeve.
26. Në qoftë se një numër real A ndodhet në një vektor $V[n]$, atëherë pas tij të shtohet vlera e dhënë B .
27. Në vektorin $Temp[365]$ janë regjistruar temperaturat maksimale të matura për Tiranën në çdo ditë të vitit. Të eliminohen nga vektori ato temperatura që janë më të mëdha se një temperaturë t e dhënë.
28. Jepen vektorët $V[m]$ dhe $X[n]$. Të ndërtohet një program në C që përcakton:
a) numrin e elementëve të përbashkët të tyre dhe i afishon ata në ekran.
b) numrin e elementëve të ndryshëm të tyre dhe i afishon ata në ekran.
29. Në vektorin $NOTAT[N]$ jepen notat e N studentëve të një grupi në lëndën e informatikës. Të ndërtohet një program në C për të gjetur:
a) Sa studentë janë mbetës dhe sa kanë marrë 10?
b) Sa studentë i takojnë grupit të notave $5 \div 9$?
c) Sa është kalueshmëria e këtij grupi në lëndën e informatikës?
d) Sa është mesatarja e notës së të gjithë grupit?
30. Të renditet vektori $V[N]$ në rend zbritës.
31. Të ndërtohet një program C për shkrirjen e 3 vektorëve të renditur.
32. Të shtohet vlera X në një vektor të renditur $V[N]$ në rend rritës pa prishur renditjen.
33. Jepet vektori $V[N]$ i renditur në rend rritës dhe një numër X . Të gjendet nëse X i përket vektorit V .
34. Në qoftë se në një vektor $V[N]$ ndodhet një numër A , atëherë të shtohet në vektor një numër tjetër B nëse
a) vektori është i parenditur (në këtë rast të shtohet në pozicionin pas numrit A);
b) vektori është i renditur (në këtë rast të shtohet në vektor në pozicionin që i takon pa e prishur renditjen).
35. Jepet një vektor me numra realë, i renditur dhe një numër A . Të fshihet numri A , nëse ai ndodhet në vektor, pa e prishur renditjen. Nëse numri A nuk ndodhet në vektor, të jepet një mesazh i përshtatshëm.